



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 433/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha, kryesues, Nenad Lazić dhe Xhevdet Abazi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e subjektit politik Progresivna Demokratska Stranka (PDS), paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 26.06.2014, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 30.06.2014, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHEN si të pabazuara ankesat e subjektit politik Progresivna Demokratska Stranka (PDS) Anr 433/2014, Anr 434/2014 dhe Anr 435/2014.

Arsyetim

Me datë 27.06.2014 PZAP-i, ka pranuar ankesat me nr. Anr 433/2014, Anr 434/2014 dhe Anr 435/2014.

- Në ankesën me numër Anr 433/2014 subjekti politik PDS thekson se ka vërejtje lidhur me punën e KQZ-së dhe PZAP-së, dhe lidhur me këtë PDS-ja disa herë ju është drejtuar KQZ-së dhe PZAP-it me një numër të madh të ankesave dhe kërkesave me të cilat është treguar për parregullsitë e vërejtura gjatë procesit zgjedhorë e që kishin të bënin me shkeljet e paligjshme të KKZ-ve dhe KVV-ve , për parregullsitë gjatë procesit të votimit si dhe për një numër të madh të parregullsive që kanë të bëjnë me votimin me kusht jashtë territorit të Kosovës, konkretisht për procesin e votimit me kusht nga territori i Serbisë. Parashtruesi ia ankesës thekson se KQZ dhe PZAP përkundër faktit se është shkelur kushtetuta dhe ligjet e Republikës së Kosovës as që janë munduar të japin përgjigje në disa ankesa dhe as që janë lëshuar në shqyrtimin dhe në besueshmërinë e pretendimeve ankimore dhe se me këtë PZAP dhe KQZ përkundër dëshmimeve që u janë dorëzuar kanë refuzuar si të pa bazuar çdo ankesë të drejtuar në këto institucione. Andaj me këtë rast subjekti politik PDS kërkon që KQZ-ja para certifikimit të rezultateve përfundimtare edhe njëherë të shqyrtoj të gjitha pretendimet ankimore të cekura

më lartë dhe të filloj procedurat penale dhe kundërvajtje ndaj personave përgjegjës. Parashtruesi i ankesës si dëshmi ka bashkangjitur ankesat e drejtuara ndaj KQZ-së lidhur me punën e KKZ-ve dhe KKV-ve , shkresat e ndryshme drejtuar KQZ-së si dhe vendimet e marra nga PZAP-i lidhur me ankesat e drejtuara në këtë institucion.

- Në ankesën me numër Anr 434/2014 subjekti politik PDS parashtron ankesë lidhur me parregullsitë për votuesit jashtë Kosovës konkretisht votat e ardhura me postë nga Serbia ku PDS ka vërtetuar një numër të konsiderueshëm të parregullsive që kanë të bëjnë me tërë procedurën e votimit në territorin e Serbisë duke filluar nga dorëzimi i formularëve për regjistrim, certifikimin e votuesve potencial e deri tek mënyra e votimit dhe e dërgimit të kuvertave me fletëvotime në QNR në Prishtinë. Andaj KQZ-ja dhe PZAP-i, duke vepruar në bazë të ankesës së PDS-së nr 373 të datës 18.06.2014, e cila ishte lidhur me parregullsitë me fletëvotimet, të ardhura përmes postës nga territori i Serbisë, ka marr vendim për refuzimin e ankesës si të pabazuar, duke mos e vërtetuar gjendjen faktike në mënyre të plote dhe të drejtë dhe duke mos i vërtetuar pretendimet në ankesë dhe se ekipi hetimor i PZAP-it, ka përdorur ekzemplarim për 6 komunat e zgjedhura rastësisht, pa i verifikuar të gjitha fletëvotimet me kusht të ardhura nga Serbia, dhe kështu vetëm pjesërisht e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe në rrethanat në bazë të cilave nuk mundet të bazohet vendimi final. PSD thekson se duke pasur qasje në listat me votat me kusht, për fletëvotimet e ardhura prej Serbisë, të cilat në QNR rishikohen dhe numërohen sipas procedurës së veçantë, mund të konkludohet qartë se në dhjetëra vendvotime të ndryshme kanë votuar fiks 200 persona, që e tejkalon mundësinë e ko incidencës dhe përputhjes, çka tregon qartë se votat e ardhura nga Serbia janë planifikuar, dakorduar dhe paraqitur në mënyrë skematike që më parë. Parashtruesi i ankesës thekson se këto parregullsi të procedurës zgjedhore në territorin e Serbisë, i mbështesin edhe deklaratat e nënshkruara personalisht nga personat të cilët pohojnë se ata nuk kanë votuar për zgjedhjet parlamentare në Kosove, dhe që të dhënat e tyre personale janë keqpërdorur, kundër vullnetit të tyre, nga personat të përgjegjës për zbatimin e procedurës së votimit në territorin e Serbisë dhe se këto deklaratat tregojnë qartë se procedura e votimit në territorin e Serbisë nuk është zbatuar sipas Kushtetutës së vlefshme, apo sipas normave ligjore dhe nënligjore. Andaj lidhur me këtë Progresivna Demokratska Stranka propozon KQZ-së që pas shqyrtimit të kësaj ankesë dhe fakteve të reja që ta pranon ankesën dhe që ta marr vendim për anulimin e të gjitha fletëvotimeve me kusht, të ardhura nga territori i Republikë së Serbisë.
- Në ankesën me numër Anr 435/2014 subjekti politik PDS parashtron ankesë në të cilën thekson se të gjitha mediat (elektronike dhe të shtypit) janë të obliguara që për të gjitha subjektet të certifikuara politike ta sigurojnë përfaqësimin e drejt dhe të sinqertë, gjatë fushatës elektorale, ndërsa të gjitha mediat elektronike duhet ta sigurojnë qasjen e drejt dhe të barabartë të emisioneve me debatet politike. Me këtë rast Progresivna Demokratska Stranka konsideron se media elektronike dhe të shtypit në Republikën e Serbisë kanë qenë të obliguar, siç kanë vepruar Mediat në territorin e Kosovës, që të respektojnë dispozitat e neneve 47, 48 dhe 49 të LZP-së, si dhe Kodin e Mirësjelljes, që të sigurojnë transparencë, demokraci dhe në vend të parë Kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e procesit zgjedhor në

territorin e Republikës së Serbisë, krejt kjo në bazë të nenit 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Mirëpo sipas PDS-së mediat elektronike dhe të shtypit nga territori i Republikës së Serbisë, në asnjë moment, gjatë zbatimit të fushatës zgjedhore në territorin e Serbisë, nuk iu janë përmbajtur dispozitave të cekura, më çka është shkelur rëndë Kushtetuta e Republikës së Kosovës si dhe gjitha aktet dhe nën akte ligjore që kanë të bëjnë me këtë çështje. Sipas parashtresit të ankesës të gjitha mediat në Republikën e Serbisë, në kundërshtim me normat relevante ligjore të Kushtetutës, kanë propaganduar, promovuar dhe përfaqësuar tek votuesit vetëm subjektin Srpska Lista ndërsa tjerët i kanë censuruar dhe parandaluar, pavarësisht a ka pas të bëjë më ndonjë listë tjetër të komunitetit serb apo komunitetit shqiptar, ose edhe me ato të ndonjë komunitetit tjetër minoritar. Sipas PDS me veprimet e tilla është shkelur rëndë parimi kushtetues për barazi dhe parimi i drejtës së qytetareve për ta votuar dhe për tu qenë votuar, si dhe me edukimin e votuesve dhe drejtimin e tyre në procesin zgjedhor të Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 107 dhe nenit 108 të LZP-së, që të gjithë votuesit ta përfitojnë imazhin e vërtetë dhe ta fitojnë informatat adekuate lidhur me opsionet e mundshme për tu mbështet. PDS-ja propozon PZAP-it që këtë ankesë ta shqyrtojë dhe të njëjtën ta pranojë, dhe që të pushojë më procesin e certifikimit të rezultateve zgjedhore pas vërtetimit e të gjitha rrethanave, si dhe ta anulojë vendimin e marr për numrin e fletëvotimeve me kusht, të ardhura përmes postes nga territori i Republikës së Serbisë dhe që secilin nga ato fletëvotimet, në bazë të arsyeve të lartcekura, t'i anuloh si të pavlefshme.

Bazuar ne nenin 6.3 të *“Rregullave dhe Procedurave”* të PZAP-it, në të cilin parashihet se: *“Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave, Kryesuesi i Panelit mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme, paneli vendim-marrës i trajton ato ankesa sikurse të ishin një ankesë”*. Në rastin konkret Kryesuesi i Panelit duke u bazuar në dispozitën ligjore të lartcekur ka vendosur ti bashkoi ankesat e sipërshënuara dhe ti trajtoi si një ankesë

PZAP-i pasi që shqyrtoj ankesat dhe shkresat e lendes gjeti se:

ankesat janë të pabazuara

Në fazën e mëparshme te procesit zgjedhor ku është vlerësuar ligjshmëria e votimit dhe e fletëvotimeve, PZAP-i ka pranuar gjashte ankesa nga gjashte subjekte politike Aleanca Kosova e Re (AKR), Nisma për Kosovën, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Lëvizja Vetëvendosje (LVV) të gjitha me seli në Prishtinë dhe Progresivna Demokratska Stranka (PDS) me seli në Graçanicë, dhe PZAP-i, lidhur me pretendimet ankimore rreth fletëvotimeve për votat e ardhura nga Serbia ka zhvilluar hetime në QNR. PZAP-i pas hetimit të fletëvotimeve të dyshimta, me vendimin e plotfuqishëm lidhur me këto ankesa A.nr.368/2014 te datës 18.06.2014, ka refuzuar ankesat e lartpërmendura duke konstatuar se pretendimet ankimore për falsifikim dhe manipulim të fletëvotime kanë qenë të pa argumentuara.

Ndërsa tani me ankesën e ankuesit përsëriten të njëjtat pretendime për të cilat si u tha më lartë është vendosur më parë.

Këto pretendime sipas vlerësimit të PZAP-it nuk i referohen keq numërimit të votave, përkatësisht administrimit të numërimit të votave në QNR në kuptim të nenit 105 të LZP, për të cilin shkak në këtë fazë të procesit zgjedhor është e lejuar e drejta e ankimit. Andaj për këto arsye nuk mund të pranohet as propozimi i ankuesit për shpalljen si të pavlefshme të këtyre fletëvotimeve. Për më tepër ata persona që dyshojnë në keq përdorimin e votës së tyre mund të drejtohen Prokurorisë së Shtetit me pretendim se kanë bërë veprë penale keqpërdoruesit e tillë. Ndërsa lidhur me pretendimet ankimore rreth mungesë së hapësirës për fushatë zgjedhore nga ana e mediave të shkruara dhe atyre elektronike PZAP-i ju udhëzon që konform nenit 52.1 të LZP-së të drejtoheni Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM).

Andaj mbi këtë bazë PZAP-i konsideron se pretendimet e parashtruara në ankesa janë të pabazuara dhe në mbështetje të në nenit 115.1 lidhur më nenin 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr. 433/2014 më datën 30.06.2014



**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**

Këshillë juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.